


# Edukata fetare e morale



HAKI SHAROFI  
ILUSTRUAR NGA K OZCAN





nga

për

data

HAKI SHAROFI

# Edukata fetare e morale



SHKUP, 2003

Copyright©Logos-A, 2003

Shënimi i CIP katalogut të këtij  
libri gjendet  
në Bibliotekën Kombëtare  
Universitare

ISBN 9989-58-056-1



Këtë libër gjithashtu mund ta gjeni  
edhe në Bibliotekën  
elektronike të Logos-A  
në adresën e internetit  
[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)

Te gjitha të drejtat janë të  
rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk  
mund të riprodhohet, vendoset në  
një sistem tërheqës apo të  
transmetohet në forma ose  
mënyra të ndryshme si elektronike,  
mekanike, fotokopje, incizime apo  
të tjera të ngjashme me këto, pa  
lejen paraprake të mbajtësit të së  
drejtës për publikim.

Shitja e këtij libri u nënshtrohet  
kushteve të veçanta të caktuara  
nga Botuesi.

Libri nuk mund të jetë objekt i  
rishitjes, i ndonjë qarkullimi tjetër  
të çfarëdo forme, apo t'i nën-  
shtrohet ndonjë ndryshimi, pa  
pëlqimin paraprak të Botuesit  
apo distribuesit të autorizuar.





# Edukata fetare e morale



shkruar nga:

HAKI SHAROFI

ilustruar nga:

KENAN ÖZCAN

përgatitur nga:

NEZHAT IBRAHIMI

MIFTAR AJDINI

# Përmbajtja

Unë jam musliman	11
Unë jam musliman i mirë	12
Çka Beson muslimani	13
Zoti i Madh	14
Pejgamberi ynë	15
Sjellja e muslimanit	16
Si e madhëron muslimani Zotin	17
Ku madhërohet All-llahu	18
Si lutet muslimani kur ulet pranë sofrës	19
Si lutet muslimani kur i kryen punët	20
Disa lutje të shkurtra dhe kuptimi i tyre	21
Melekët (engjëjt)	22
Kur'ani	23
Dëgjimi i prindërve	25
Sjellja e mirë ndaj çdokujt	26
Lutja për prindërit	27
Lutja e jetimëve	28
Jeta pas vdekjes	29
Disa lutje të shkurtra	31
Himni fetar	32





Xhamia	36
Pse muslimanët shkojnë në xhami?	42
Festat fetare të muslimanëve	46
Bajrami	49
Urimet e Bajramit	53
Besimet e përbashkëta të tyre	
që shkojnë në xhami	56
Kush na e ka mësuar fenë?	63
Hazreti Muhammedi dhe jeta e Tij	65
Abdesi	71
Të falurit – namazi (lavdërimi i Zotit)	79
Netët e mira (të mëdha)	93
Ramazani dhe agjërimi	96
Ndihma të varfërve	100
Bajrami i kurbanit	105
Haxhilerët	108
Morali i hazreti Muhammedit A.S.	III
Ndihma ndaj të afërmeve	115
Ndihma bashkatdhetarëve	
dhe mbarë njerëzimit	118
Disa pjesë të shkurtra të Kur'anit	121





بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

NE EMËR TË  
ALL-LLAHUT,  
TË GJITHË MË SHIR SHMIT,  
MË SHIRË PLOTT





# Pjesa e parë

Përgatiti: Nexhat Ibrahim





# Unë jam musliman

Zoti im është All-llahu i  
Madhërueshëm.

Pejgamberi im është hazreti  
Muhammedi alejhisselam.

Feja ime është Islami.

Muslimani duhet të jetë njeri i mirë,  
i urtë, i sjellshëm, i pastër dhe i  
dëgjueshëm.

Pyetje:

Çka je ti?

Kush është Zoti yt?

Kush është Pejgamberi yt?

Cila është feja jote?

Çfarë njeriu duhet të jetë muslimani?

## 2 Unë jam musliman i mirë

Unë jam musliman i mirë, sepse punoj siç ka urdhëruar All-llahu i Madhërueshëm dhe Pejgamberi i dashur.

All-llahu i Madhërueshëm dhe Pejgamberi i dashur na kanë urdhëruar të jemi të mirë, të urtë, të sjellshëm, të pastër dhe të dëgjueshëm.

Edhe unë pra, jam i mirë, i urtë, i sjellshëm, i pastër dhe i dëgjueshëm.

Pyetje:

Pse je musliman i mirë?

Çka kanë urdhëruar All-llahu i Madhërueshëm dhe Pejgamberi i dashur?

Çfarë (si) je ti?



# 3 Çka Beson muslimani

Muslimani e beson Zotin e Madhërueshëm dhe Pejgamberin e dashur.

Zoti jonë është All-llahu i Madhërueshëm, ndërsa Pejgamberi ynë është hazreti Muhammedi alejhisselam.

All-llahu i Madhëruar na do shumë, prandaj edhe ne duhet ta duam Atë shumë.

Pyetje:

Çka Beson muslimani?

Kush është Zoti ynë?

Kush është Pejgamberi ynë?

A na do shumë All-llahu i Madhëruar?

Po hazreti Pejgamberi alejhisselam a na do shumë?

# 4 Zoti i Madh

Zoti ynë është All-llahu i Madhërueshëm.

Ai i ka krijuar qiejt, tokën, malet, fushat, njerëzit, shtazët, bimët dhe çdo gjë tjetër që ekziston në botë.

All-llahu i Madhëruar është kudo, na sheh çka bëjmë dhe na dëgjon çka flasim. Prandaj vazhdimisht duhet të bëjmë punë të mira dhe të flasim fjalë të mira.

Pyetje:

Kush është Zoti ynë?

Çka ka krijuar All-llahu i Madhëruar?

Kush është All-llahu i Madhëruar?

Pse duhet të bëjmë mirë dhe pse duhet të flasim fjalë të mira?



# 5 Pejgamberi ynë

Pejgamberi ynë është hazreti Muhammedi alejhisselam.

Hazreti Muhammedi alejhisselam ka qenë njeri shumë i mirë dhe shumë i urtë, madje më i mirë dhe më i urtë se çdo njeri tjetër.

Ky zotëri i ndershëm na i ka komunikuar urdhrat e Zotit të Madhërueshëm, prandaj i thonë Pejgamber.

Hazreti Muhammedi alejhisselam ka ndërruar jetë, por na e ka lënë Librin e shenjtë të quajtur Kur'an.

Kur'ani është fjala e Zotit të Madhërueshëm, që na mëson se si mund të bëhemi njerëz të mirë.

Pyetje:

Kush është Pejgamberi ynë?

Çfarë njeriu ka qenë hazreti Muhammedi alejhisselam?

Pse i thonë hazreti Muhammedit Pejgamber?

Ç'na ka lënë hazreti Muhammedi alejhisselam?

Ç'është Kur'ani?

# ↳ Sjellja e muslimanit

Musliman i thonë njeriut që e beson All-llahun e Madhëruar dhe hazreti Pejgamberin alejhisselam.

Muslimani punon siç ka urdhëruar All-llahu i Madhëruar.

Ai e hyjnon Zotin e Madhëruar, i falënderohet për të mirat që ia jep dhe i lutet që t'ia shtojë këto të mira.

Muslimani i do shumë prindërit e vet dhe i dëgjon këshillat e tyre.

Muslimani i nderon të mëdhenjtë, sillet mirë me miqtë e vet dhe i do shumë të vegjëlit.

Pyetje:

Kujt i thonë musliman?

Si punon muslimani?

Si sillet muslimani ndaj All-llahut të Madhëruar?

Si sillet muslimani me prindërit?

Si sillet muslimani me të mëdhenjtë, me miqtë dhe me të vegjëlit?



# 7 Si e madhëron muslimani Zotin

Muslimani e madhëron Zotin duke i kryer urdhrat dhe porositë e Tij, të cilat janë dhënë në Kur'an.

Urdhrat dhe porositë e Zotit na i mësojnë hoxhallarët dhe mësuesit e mësim-besimit. Prandaj, kërkohet t'i duam dhe t'i nderojmë shumë këta zotërinj që na e mësojnë fjalën e Zotit.

Që të dimë ta madhërojmë Zotin ashtu siç kërkohet, duhet vijuar mësimi në shkollat e besimit dhe duhet dëgjuar mësimet e fesë.

Pyetje:

Si e madhëron muslimani Zotin?

Kush na i mëson urdhrat dhe porositë e Zotit?

Pse duhet të vazhdojmë (të mësojmë) në shkollat e mësim-besimit?



# 8 Ku madhërohet All-llahu

Muslimani e madhëron All-llahun kudo, por vendi më i përshtatshëm për ta madhëruar All-llahun është xhamia.

Xhamia ka një minare, ku hipën muezini për ta thirrur ezanin dhe që t'i lajmërojë muslimanët për kohën e faljes së namazit.

Në xhami muslimanët falen së bashku duke e pasur përpara imamin.

Pyetje:

Ku e madhëron muslimani All-llahun?

Ç'është xhamia?

Ç'është minarja?

Ç'është muezini?

Si falen muslimanët në xhami?

# 9 Si lutet muslimani kur ulet pranë sofrës

Muslimani para se të ulet pranë sofrës, i lan duart e pastaj fillon të hajë bukë duke thënë:

“Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim”.

Këtë lutje muslimani e bën edhe në fillim të çdo pune tjetër.

Me këtë lutje ai e kërkon ndihmën e Zotit të Madhëruar, që t’i kryhet puna si është më mirë.

Atëherë edhe All-llahu i Madhërueshëm ia sjell shumë mbarë muslimanit në kryerjen e punëve që fillohen me këtë lutje.

Pyetje:

Ç’bën muslimani para se të ulet pranë sofrës?

Si i fillon punët muslimani?

Pse lutet muslimani kur fillon të punojë?

Si kryhen punët që fillohen me "Bismilah"?



# 10 Si lutet muslimani kur i kryen punët

Muslimani në mbarim të çdo pune e madhëron Zotin e Madhëruar duke thënë:

“El-hamdu lil-lah”!

Këtë lutje muslimani duhet ta bëjë çdoherë kur ta përfundojë ngrënien dhe çdoherë kur ta kryejë ndojë punë sipas dëshirës që e ka.

“El-hamdu lil-lah” do të thotë, falënderimi i qoftë All-llahut që na ndihmon t’i kryejmë punët dhe na i plotëson dëshirat.

Pyetje:

Si e madhëron muslimani All-llahun?  
Kur duhet të thuhet “El-hamdu lil-lah”?  
Ç’do të thotë “El-hamdu lil-lah”?



# || Disa lutje të shkurtra dhe kuptimi i tyre

- Subhan' All-llah (Madhëria i qoftë All-llahut).

- El-hamdu lil-lah (Falënderimi i qoftë All-llahut).

- All-llahu ekber. (All-llahu është më i madhi).

- La ilahe il-lall-llah. (Nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut)

- Muhamedun resulull-llah.  
(Muhammedi është i Dërguari i All-llahut).

- Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu. (Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër, përveç All-llahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është rob dhe i dërguar i Tij).

# 12 Melekët (engjëjt)

Melekët janë krijesa të All-llahut që nuk shihen me sy.

Ato janë krijesa të urta që nuk gabojnë kurrë.

Melekët gjithmonë punojnë sipas porosisë së All-llahut të Madhërueshëm dhe kurrë e nuk shkelin urdhrin e Tij.

Edhe ne duhet të bëhemi të urtë e të dëgjueshëm si melekët.

Pyetje:

Çka janë melekët?

Si janë melekët?

Si punojnë melekët?

Si duhet të bëhemi ne?



# 13 Kur'ani

Kur'ani është libër i shenjtë ku janë të shkruara urdhrat e All-llahut të Madhëruar.

All-llahu i Madhërueshëm na i ka treguar urdhrat e Tij me anë të hazreti Muhammedit alejhisselam, i cili është Pejgamberi ynë i dashur.

Kur'ani është fjalë e Zotit, prandaj edhe duhet ta respektojmë sa herë kur e përkujtojmë apo e kemi në dorë.

Çdo shtëpi muslimane duhet të ketë një Kur'an.

Kur'ani duhet të futet në një çantë apo në mbështjellëse të bukur dhe të mbahet në krye të vendit, në raftin e librave.

Çdo musliman duhet të dijë ta lexojë Kur'anin.

Pyetje:  
Ç'është Kur'ani?  
Nëpërmjet kujt All-llahu i Madhëruar  
na i ka transmetuar urdhrat e Tij?  
Pse duhet të respektohet Kur'ani?  
Çka duhet të ketë çdo shtëpi  
muslimane?  
Si duhet të mbahet Kur'ani?  
Çka duhet të dijë çdo musliman?





# 14 Dëgjimi i prindërve

All-llahu i Madhëruar në Kur'an na urdhëron që prindërit t'i duam shumë.

Babai dhe nëna kujdesen shumë për të mirën tonë, prandaj edhe ne duhet t'i duam, nderojmë dhe t'i dëgjojmë.

Ne duhet t'u ndihmojmë dhe t'u shërbejmë kur të kenë nevojë; t'i përqafojmë kur të shkojmë në shkollë dhe kur të kthehemi prej saj, t'u themi gjithmonë fjalë të mira e mos t'u themi kurrë fjalë të rënda e të liga.

Zoti i Madhëruar i do shumë fëmijët që i duan, i nderojnë dhe i dëgjojnë prindërit e tyre.

Pyetje:

Çka na urdhëron Zoti i Madhëruar në Kur'an në lidhje me prindërit?

Pse duhet t'i duam, t'i nderojmë dhe t'i dëgjojmë Babanë dhe nënën?

Si duhet të sillemi ndaj Babait dhe nënës?

A i do Zoti fëmijët që i duan prindërit e tyre?

# 15 Sjellja e mirë ndaj çdokujt

Muslimani sillet mirë me çdokënd dhe nuk e ngacmon askënd.

Ai sillet mirë me vëllezërit, me motrat, me miqtë dhe me çdokënd tjetër.

Muslimani duhet të sillet mirë edhe me të varfërit, të cilët, sipas mundësive, duhet edhe t'i ndihmojë.

All-llahu i Madhëruar i do shumë fëmijët që sillen mirë me vëllezërit, me motrat dhe me shokët e tyre.

Pyetje:

Si sillet muslimani me të tjerët?

Si duhet të sillet muslimani me të varfërit?

Cilët fëmijë All-llahu i Madhëruar i do shumë?



# 16 Lutja për prindërit

Zot i Madh, të qofsha falë,  
Bab' e nan' që m'i ke falë;  
T'lutem m'i ruej e m'i fal,  
Se i kam si sytë në ballë!

Zot i Madh, Ti qofsh lavdue,  
Lutem doret mos me i l'shue  
Nan' e bab' që m'ke fal' mue,  
Nat' e dit' me u ndihmue...

# 17 Lutja e jetimëve

Bab' e nanë ata që s'kanë  
Zot, me Ty shpresën e kanë,  
Me u ndih e me u dhanë  
Çdo nevoj' ata që kanë.

Zoti i Madh e i Vërtetë,  
Për jetimët në këtë jetë  
Dhim' e kujdes ke Ti vetë;  
Pra, ata nuk janë të shkretë...



# 18 Jeta pas vdekjes

Njeriu është krijuar prej trupit dhe shpirtit.

Kur njeriu vdes, shpirti i tij del prej trupit. Pastaj All-llahu do ta ringjallë përsëri dhe do ta pyesë sesi është sjellë në këtë botë.

Në qoftë se ka qenë njeri i mirë dhe i urtë, All-llahu me mëshirën e vet e shpie në lulishtet e bukura të xhennetit, ku i ka të gjitha të mirat dhe jeton i gëzuar e i lumtur përgjithmonë.

Njeriu i cili s'është i mirë dhe i urtë, duhet të heqë dorë nga sjelljet e liga dhe të kërkojë falje për gabimet që i ka bërë.

Njeriu që s'heq dorë nga sjelljet e liga dhe që nuk kërkon falje për gabimet që i ka bërë, nuk do jetë i lumtur dhe i gëzueshëm në jetën pas vdekjes.

Pyetje:  
Prej çka është krijuar njeriu?  
Çka do të ndodhë me njeriun pas vdekjes?  
Ku shkon njeriu i mirë dhe i urtë?  
Çka duhet të bëjë njeriu i keq?  
Çka do të ndodhë me njeriun që  
s'heq dorë nga sjelljet e liga?





# 19 Disa lutje të shkurtra

1. -All-llahum-me sal-li ala sej-jidina  
Muhammedinin nebij-ji-l-um-mij-ji  
ve ala alihi ve sahbihi ve sel-lim

2. - All-llahum-me sal-li ale-l Mustafa,  
nebij-jun resulun ve bahru-s-safa.

All-llahum-me sal-li ale-l-Hashimi,  
beshirun nedhirun ale-l-alemi.

All-llahum-me sal-li ale-l-Fatihi  
kunuzu-l-hakaik, ebu-l-ervahi.

3. - All-llahu ekber All-llahu ekber,  
la ilahe il-'All-llah, v'All-llahu ekber  
All-llahu ekber ve li-l-lahi-l-hamd.

# Himni fetar

Qabja e Madhnueshme  
Qabja e madhnueshme po priste,  
Që njeriu i mirësisë  
Ta pastronte, ta stoliste  
Vendin e shenjt' të njerëzisë.

Leu në zemër t'Arabisë  
Porsi dielli në mëngjes,  
I dha shpresë gjithësisë  
Si trëndafil me vesë.

Kur ka le, aman o Zot,  
Sa gëzim i madh u ba?  
Gjithë i than' tue derdhun lot:  
“Mirë se erdhe, merhaba!”

Mirë se vjen Resul i pritun!  
Mirë se vjen për botën mbarë!...  
Zoti ty t'ka porositun:  
Ta udhëheqësh pa e ndarë!...



Mirë se vjen, o Rob i Zotit,  
Mirë se vjen, o Nur' i Tij!  
Ti je shpresa e kahmotit,  
Vetëm ti je, vetëm ti !...

*Hysni Bushati*











## Pjesa e dytë

Përgatiti: Miftar Ajdini

# Xhamia<sup>1</sup>

Të gjithë ju keni parë xhami. E dini se kjo është një ndërtesë e madhe ku i falemi All-llahut. Këtu më sipër e shihni xhaminë. Në ilustrimin vijues është paraqitur pamja e saj e jashtme. Siç po shihni, xhamia është një ndërtesë e madhe, e lartë dhe me shumë dritare. Nga të gjitha anët në të lirshëm depërtojnë drita, dielli dhe ajri.

Pra, ai është tempulli më i pastër e më i shndritshëm. Xhamia nga ana e djathtë e ka minaren, që është e hollë dhe mjaft e lartë. Aty, kah mbarimi i trupit të minares do të hasim në ballkonin të cilin e quajmë “sherife” dhe ndriçohet me poça elektrike ose me kandila. Pjesa e sipërme e minares, shkon kah qielli duke u holluar dhe merr fund në një majë që lidhet me një rrufepritës. Kulmi

---

<sup>1</sup> Për ta mësuar më mirë këtë mësim, nxënësit duhet të dërgohen në ndojë xhami, ku ky mësim do të mund të mbahej në mënyrë praktike.



i minares, i cili fillon dy-tre metra mbi ballkonin, është i mbuluar me plumb. Minarja përbrenda s'është tjetër, veçse një shkallë e tërthortë që fillon nga toka dhe përfundon në kulm. Nëpër këtë shkallë muezini hipën në ballkonin e minares, prej nga i lajmëron muslimanët se ka ardhur koha për t'iu lutur Zotit. Lajmi të cilin e kumton muezini quhet “ezan”.

Tash të hyjmë brenda në xhami e t'i shohim pjesët e saj. Me vënien e këmbës në prag të xhamisë, kemi hyrë në pjesën e korridorit të xhamisë e cila quhet “hajat”. Rruga që i bashkon dy portat e xhamisë e ndan korridorin e saj në dy pjesë quhet “çardak”.

Me të hyrë brenda në xhami, në murin përballë portës shihet një skutë që i ngjason oxhakut të vatrës. Ky vend quhet “mihrab”. Aty falet imami. Duke qëndruar me fytyrë kah mihrabi, nga e djathta kemi “minberin” që është i ndër-tuar nga dhjetë shkallë dhe nga një



kthinë e vogël në krye. Nga këto shkallë ditën e premte imami i mban këshillat e së premtes. Këto këshilla quhen “hutbe”, kurse imami i cili e mban hutben quhet “hatib”. Kthina e minberit është e gjerë rreth një metër katror, ndërsa lartësia e saj rreth një metër e gjysmë deri në dy metra. Kulmin e ka në formë të një piramide të bukur që zgjatet deri në tavan të xhamisë.

Nga ana e majtë e mihrabit është selia e predikuesit e cila quhet “kursi”. Brenda mbi portën e xhamisë, midis dy mureve djathtas e majtas, shtrihet një çardak i cili quhet “mahfil”. Këtu falet muezini.

Xhamia është e shtruar me dërrasa, e sipër tyre mbulohet me qilima. Nëpër mure janë të varura mbishkrimet me urdhra të lartë të Kur’anit. Në tavan janë poçat elektrikë... Në xhami nuk hyhet me këpucë dhe nuk lejohet të pështyhet. Ai është vend i shenjtë, andaj duhet të mbahet shumë i pastër.



Në xhami muslimanët i luten All-llahut, prandaj edhe quhet “Shtëpia e Zotit”.

Edhe ata që hyjnë në xhami duhet të jenë të pastër, si në veshmbathje ashtu edhe në trup. Muslimani që hyn në xhami duhet që më parë të pastrohet (në banjë) ose të marrë abdest, e pastaj të hyjë në xhami.

Faltarit nuk duhet t’i vijë era e qepës ose hudhrës, as era djersë, e sidomos era e çorapeve dhe këmbëve.

Nëse është e mundur, muslimani është mirë të lyhet me erëra të mira, por jo shumë të forta. Në xhami duhet të mbretërojnë heshtja dhe qetësia e plotë, pra aty nuk duhet të bisedohet.

## Përkufizim

Xhamia është një ndërtesë e madhe, e bukur dhe e pastër, ku muslimanët falen dhe i luten Zotit të Madhëruar.

Ajo dallohet nga objektet tjera me minaren e saj të hollë e të lartë. Në ballkonin e minares hipën muezini për ta thirrur ezanin dhe për t'i lajmëruar muslimanët për kohën e faljes (namazit).

Xhamia është e shtruar me dërrasa e sipër tyre e mbuluar me qilima të pastër. Në xhami nuk hyhet me këpucë e as nuk pështyhet. Njerëzit që hyjnë në xhami duhet të jenë të pastër. Në xhami duhet të mbretërojnë heshtja dhe qetësia e plotë.

Pyetje:

Çka është xhamia dhe cili është qëllimi i saj?

Pse xhamia ka shumë dritare?

Çka është minarja dhe si është ajo?

Për çka shërben ballkoni i minares?

Si hipet në ballkon?

Çka bën muezini në ballkon?

Cilat janë pjesët e brendshme të



xhamisë?

Ku gjendet korridori i xhamisë, në sa pjesë ndahet dhe si quhen ato pjesë?

Cila pjesë e xhamisë quhet mihrab dhe për çka shërben ai?

Cila pjesë e xhamisë quhet minber dhe për çka shërben?

Çka është hutbja dhe kush quhet hatib?

Ku gjendet kthina e minberit?

Ç'formë ka kthina e minberit?

Cili vend quhet "Selia e predikuesit"?

Cili vend quhet mahfil?

Si është e shtruar xhamia?

Çka përmbajnë mbishkrimet në muret e xhamisë?

Me çka ndriçohet xhamia?

Pse nuk hyhet me këpucë brenda në xhami?

Pse xhamia quhet "Shtëpia e Zotit"?

Çka duhet të bëjnë ata që hyjnë në xhami?

Pse në xhami nuk bëhet zhurmë?

## 2 Pse muslimanët shkojnë në xhami?

Muslimanët dhe muslimanet duhet t'i jenë mirënjohës Zotit të Madhëruar për të mirat e shumta që ua ka dhuruar. Muslimani këtë mirënjohje e bën të ditur duke e lartësuar të madhin Zot, duke iu lutur dhe duke iu falur. Muslimanët mund t'i luten Zotit në çdo vend, me kusht që ky vend të jetë i pastër. Por, falja në xhami në xhemat (bashkësi), është më e vlefshme dhe më e pëlqyer. Nga të falurit në xhami kemi shumë dobi. Së pari, aty gjejmë një grup shokësh, me të cilët duke u parë më shpesh, njihemi më mirë dhe na shtohet dashuria më shumë.

Në xhami i gjejmë njerëzit më të mirë. Njerëzit e xhamisë i dëgjojnë më shpesh urdhrat e Zotit dhe të Pejgamberit. Pra, ata janë njerëz të urtë e të sjellshëm. Ata nuk janë alkoolistë,



d.m.th., nuk pijnë verë, nuk luajnë bixhoz dhe nuk bëjnë punë të tjera të liga.

Njerëzit të cilët shkojnë në xhami, e kanë për detyrë të pastrohen, sepse në xhami nuk mund të hyjnë ata që nuk janë të pastër.

Ata të cilët shkojnë në xhami, mësohen t'i nënshtrohen më tepër rregullit dhe disiplinës, sepse në xhami do të falen së bashku pas një imami, e kjo gjë i stërvit në rregull dhe disiplinë.

Meqë në xhami mbretërojnë heshtja dhe qetësia e plotë, edhe të falurit bëhet më me shpirt dhe më me zemër.

Përveç këtyre, në xhami shpeshherë organizohen edhe predikime e këshilla, me të cilat na zbutet zemra, na kënaqet shpirti, na shtohet kultura fetare, shoqërore e morale dhe kështu vazhdimisht sjelljet tona përmirësohen.

Më në fund, në xhami e dëgjojmë fjalën e Zotit, Kur'anin, të cilin e këndon imami me zë të bukur. Kur'ani është ushqimi më i mirë, më i ëmbël dhe më i dobishëm i shpirtit.

Ai që dëshiron të kënaqet me këto të mira të xhamisë, duhet të shkojë rregullisht në xhami, sidomos në ditët e shenjta të festave, sepse në këto ditë ka rast të mësojë edhe për historinë e këtyre festave të bekuara.

## Përkufizim

Muslimanët shkojnë në xhami për t'iu lutur Zotit të Madhëruar. Ata që shkojnë në xhami rregullisht, i dëgjojnë më shpesh urdhrat e Zotit e të Pejgamberit, prandaj ata janë njerëz të urtë e të sjellshëm, nuk pijnë alkool, nuk luajnë bixhoz dhe nuk bëjnë punë të liga.

Muslimanët duhen të shkojnë rregullisht në xhami, në qoftë se dëshirojnë të bëhen njerëz të mirë.

Pyetje:

Çfarë detyra ka muslimani ndaj Zotit të Madhëruar?

Si e shfaq muslimani mirënjohjen ndaj Zotit?

Ku i luten All-llahut muslimanët?



Pse është më i vlefshëm dhe më i dobishëm të falurit në xhami?

Tregoni disa dobi nga shkuarja në xhami!

Pse njerëzit që shkojnë në xhami janë më të mirë?

Pse njerëzit që shkojnë në xhami janë më të rregullt e më të disiplinuar?

Pse xhamia i rregullon dhe i përmirëson sjelljet tona?

Pse Kur'ani na kënaq?

Pse duhet të shkojmë në xhami gjatë ditëve të festave?



# 3 Festat fetare të muslimanëve

Muslimanët në disa ditë të caktuara të vitit i kanë festat e tyre, që kremtohen në shenjë kujtimi të disa ngjarjeve të mëdha, që kanë ndodhur në dobi të njerëzimit.

Ata nuk kanë shumë festa të këtilla, sepse Islami është fe e punës, andaj edhe festat i ka të kufizuara.

Dita e takimit javor në Fenë Islame është dita e premte. Në këtë ditë muslimani duhet të pushojë nga puna, të lahet e të pastrohet, t'i veshë rrobat më të bukura që mund t'i ketë, ta vizitojë farefisin, të afërmit, dashamirët dhe miqtë e tij, ose t'i presë në shtëpi vizitat e tyre.

Një orë para drekës duhet të merret abdest, të shkohet në xhami dhe të falet xhumaja. Kështu duhet të veprojnë të gjithë pjesëtarët e bashkësisë Islame.



Dita e premte është ditë fetare e urdhëruar me Kur'an, andaj medoemos duhet të respektohet, e sidomos ora e të falurit të xhumasë. Ata që nuk e mbajnë këtë ditë, duhet ta dinë se e kanë shkelur urdhrin e All-llahut të Madhëruar, i Cili është mbi çdo urdhër tjetër.

Kështu duhet të shënohen edhe festat tjera islame, siç janë netët e mira dhe Bajramet.

Këto festa do t'i shpjegojmë një nga një kur t'u vijë radha.

## Përkufizim

Festat muslimane janë të pakta. Ditë e takimit javor në Fenë Islame është dita e premte.

Të premtën çdo musliman duhet të lahet e të vishet me rrobat më të bukura që i ka. Një orë para drekës duhet të merret abdest e të shkohet në xhami për ta falur xhumanë. Këtë falje e ka urdhëruar All-llahu i Madhëruar me Kur'an. Ata që nuk e falin xhumanë, e kanë shkelur urdhrin e Tij.

Pyetje:


Çka janë festat fetare?

Pse Feja Islame nuk ka shumë festa?

Cila është dita e pushimit javor për muslimanët?

Çka duhet të bëjë muslimani në ditën e pushimit javor?

Kush na urdhëron ta veçojmë ditën e premte?





## 4 Bajrami

Bajrami është një festë e madhe fetare. Në ditët e Bajramit të gjithë muslimanët e botës kanë gëzim. Prandaj, gjatë këtyre ditëve nuk punohet, por vetëm vërehet gëzimi.

Për të qenë muslimanët të gëzuar gjatë ditëve të Bajramit, ata fillojnë të përgatiten disa ditë më parë. E lajnë dhe pastrojnë shtëpinë gjerë e gjatë, ngjyrosin ose gëlqerosin, i pastrojnë dhe i rregullojnë mobiliet etj. Po ashtu qepin rroba të reja për vete dhe për fëmijët e tyre, por nuk i harrojnë edhe miqtë e tyre të varfër. Atyre u ndihmojnë me para, rroba dhe ushqime.

Siç shihet, të gjithë muslimanët në Bajram i kanë të plotësuara nevojat e tyre; pasaniku nga një anë i plotëson nevojat e veta, e në anën tjetër mendon edhe për të varfërit.

Muslimani i mirë e i vërtetë nuk kënaqet me të mirat e veta, por dëshiron t'i shohë të gëzuar edhe miqtë e tij të varfër.



Muslimani ditën e parë të Bajramit duhet të lahet e të pastrohet mirë, pastaj të vishet me rroba të pastra dhe të shkojë në xhami, për ta filluar festën duke iu falur Zotit për të mirat e pashtershme që ia ka dhënë.

Të gjithë ata të cilët kanë shkuar në xhami, pasi ta kryejnë detyrën e të falurit, kthehen në shtëpitë e tyre, ku me gëzim përshëndeten dhe ia urojnë Bajramin shoqi-shoqit, duke ia shtrënguar duart njëri-tjetrit.

Pastaj e hanë drekën e Bajramit me të gjitha të mirat që i ka dhënë Zoti. Por, pije alkoolike si verë, raki, birra dhe pije të tjera të dëmshme, nuk lejohet të ketë në tryezën e muslimanit. Këto pije të rrezikshme janë të ndaluara për muslimanët. Ky ndalim në fenë tonë quhet haram, që do të thotë vetë All-llahu i Madhëruar në Kur'an na e ka ndaluar përdorimin e pijeve alkoolike.

Fatkeqësisht, në disa vise muslimanët për Bajram i gostisin miqtë e tyre me



nga një gotë alokool. Kjo gjë është kundër urdhrit të Zotit. Bajrami festohet që të na i sjellë ndërmend urdhrat e Zotit, e kurrsesi për t'i shkelur ato.

Muslimanët kanë dy Bajrame në vit: Bajramin e Madh dhe Bajramin e Vogël, Bajramin e Ramazanit dhe Bajramin e Kurbanit ose Bajramin e Haxhit.

Bajrami i Ramazanit zgjat tri ditë dhe festohet për ta lavdëruar All-llahun xh.sh. e për t'u gëzuar për të mirat që i fitojnë muslimanët nga agjërimi i Ramazanit. Këto të mira të shumta do t'i shohim më mirë kur ta studiojmë muajin e Ramazanit.

## Përkufizim

Bajrami është festë e madhe që i gëzon të gjithë muslimanët.

Muslimani i mirë e i vërtetë nuk kënaqet me të mirat e veta, por dëshiron t'i shohë të gëzuar edhe miqtë e tij të varfër.

Muslimani në ditën e parë të Bajramit lahet e pastrohet mirë, i ndërron e i vesh rrobat e pastra dhe shkon në xhami që t'i lutet All-llahut xh.sh.

Muslimanët kanë dy Bajrame në vit: Bajramin e Ramazanit dhe Bajramin e Kurbanit ose të Haxhit.

Pyetje:

Ç'është Bajrami?

Ç'bëjnë muslimanët që të jenë të gëzuar në Bajram?

Me çka kënaqet muslimani i mirë?

Çka bën muslimani në ditën e parë të Bajramit?

A përdor muslimani pije alkoolike?

Sa Bajrame kanë muslimanët?

Sa ditë zgjat Bajrami i Ramazanit dhe pse festohet?



# 5 Urimet e Bajramit

Festat fetare të muslimanëve janë festa shoqërore dhe kremtohen me familje, me shoqëri, me farefis, me miq e me dashamirë. Gjatë këtyre festave, muslimani, varësisht nga kushtet dhe mundësitë, do të bëjë ose do të kthejë vizita.

Vizitat e Bajramit bëhen për t'i uruar njëri-tjetrit gëzim dhe lumturi të përhershme.

Fjalët popullore të cilat përdoren me rastin e urimeve janë:

“E gëzofshi Bajramin!”; “Për shumë mot gëzuar!”; “Për shumë vjet gëzuar!”; “Me fat u qoftë Bajrami!” etj. Përgjigjet për këto urime jepen me këto shprehje: “Ju falemnderit!”, “Gëzuar qofshi!”, “Gaz paçi!”, “Gaz e lumturi paçi!”, “Bashkë me Zotin tuaj!”, “Qofshi shëndoshë” dhe “Edhe juve u qoftë me fat!” etj.

Në qoftë se na vijnë shumë miq e nuk arrijmë që t'ua kthejmë të gjithëve vizitat e urimit, atëherë këtë lëshim e



plotësojmë me dërgimin e një karte-urimi nëpërmjet postës brenda ditëve të Bajramit.

Me njerëzit që gjenden jashtë qytetit tonë, urimet i shkëmbejmë telegrafisht ose me kartë-postare.

Vëllezërve tanë të besimeve të tjera që na vizitojnë për Bajram, nuk ua kthejmë vizitat, por u shprehim falënderime me anë të një kartëvizite dhe bëjmë përpjekje që t'ua kthejmë këtë vizitë gjatë ditëve të festave të tyre.

Po që se ndodh që me rastin e ndonjë vizite nuk e gjejmë të zotin e shtëpisë, nuk hyjmë fare brenda, por vetëm ia lëmë një kartëvizitë.

Muslimanët e vërtetë nuk duhet t'u përshtaten shumë rregullave të shoqërisë evropiane. Bie fjala, zonja muslimane nuk do t'ia japë dorën të huajit që ai t'ia puthë. Zonja muslimane kurrë nuk duhet t'i heqë dorëzat nga duart kur takohet me një të huaj. Zonja muslimane, si edhe zotëriu musliman, duhet



të qëndrojë brenda këtij kufiri.  
Muslimani duhet t'u përmbahet  
urdhrave shoqërore të fesë, e jo  
deformimeve të jetës së shfrenuar.

## Përkufizim

Festat fetare të muslimanëve,  
sidomos ato të Bajrameve, kremtohen  
me miq. Në festat e Bajramit muslimanët  
bëjnë vizita midis tyre, për t'i uruar njëri-  
tjetrit gëzim e lumturi të përhershme.

Nganjëherë këto urime dërgohen me  
anë të telegrameve ose me karta postare.

Pyetje:

Si kremtohen festat fetare të  
muslimanëve?

Pse bëhen vizitat e Bajramit?

Cilat fjalë përdoren për urimin e  
Bajramit?

Kur përdoren kartë-vizitat?

Si u urohet Bajrami njerëzve të  
largët?

Ç'bën muslimani kur nuk e gjen në  
shtëpi zotëriun që e viziton?

# Besimet e përbashkëta të atyre që shkojnë në xhami

## I. Besimi në një Zot

Të gjithë ata që shkojnë në xhami, kanë një besim dhe një qëllim. Ata besojnë në një Zot të vërtetë dhe të gjithë i luten njëllë. Ata që shkojnë në xhami edhe veprimet i kanë të njëjta. Për të parë se vërtet i kanë të njëjta veprimet dhe punët, duhet të shkojmë në xhami edhe ne, pasi aty mund të shohim çka bëjnë dhe si luten muslimanët.

Besimi i parë i cili i bashkon muslimanët është “Besimi në Një Zot të Vërtetë dhe të Amshueshëm”.

Zoti i Vërtetë dhe i Amshueshëm është vetëm Një, i Cili ka ekzistuar, ekziston dhe do të ekzistojë gjithnjë.



Zoti e ka krijuar Gjithësinë dhe çdo gjë. Pra, Zoti ka ekzistuar edhe kur nuk kanë ekzistuar Gjithësia dhe njerëzia. Zoti ka ekzistuar vetvetiu e nuk është i krijuar apo i lindur. Ky pra është Zoti i Vërtetë e i Amshueshëm. Këtë Zot muslimanët e quajnë All-llah.

Themi Zot i vërtetë për ta rrënuar dogmën e gabueshme të atyre që besojnë në zotëra të rrejshëm. Në botë ka njerëz që besojnë se lopa është Zot; ka të tjerë që e besojnë zjarrin për Zot; ka të tillë që diellin e besojnë për Zot, por edhe të atillë që peygamberin e tyre e kanë shndërruar në Zot etj.

Zoti i vërtetë ka ekzistuar dhe do të ekzistojë. Vetëm Zoti krijon çdo gjë dhe ka fuqi të plotë.

Siç shihet, muslimanët bashkohen në besimin dhe në madhërimin e Zotit të Vërtetë e të Amshueshëm, prandaj janë vëllezër të një feje.



## 2. Pejgamberi

Muslimanët e kanë njohur Zotin nga mësimet që i kanë lënë disa njerëz të mëdhenj e të shenjtë. Këta quhen të dërguar ose pejgamberë. Pejgamberët i ka mësuar vetë Zoti dhe i ka porositur që t'ua mësojnë njerëzve mënyrën sesi duhet të besohet Zoti, si duhet t'i lutemi dhe si duhet të bëjmë punë të mira në këtë botë.

Pejgamberët kanë qenë njerëz sikur ne, por shumë të ditur dhe të sjellshëm.

Zoti i Madhëruar i ka dërguar njerëzisë, kohë pas kohe e sipas nevojës, shumë pejgamberë. Numrin e tyre nuk e di askush, përveç Zotit. Ai na i ka dëftuar disa emra të këtyre të dërguarve të cilët do t'i mësojmë më vonë. Tash për tash mjafton që ta dimë vetëm të parin dhe të fundin: i pari ka qenë hazreti Ademi a.s., ndërsa i fundit ka qenë hazreti Muhammedi a.s.

Ne i besojmë të gjithë pejgamberët dhe punojmë sipas urdhrimit të hazretit Muhammedit a.s., pejgamberit të fundit.



Urdhrrat e hazreti Muhammedit a.s. janë më të rinj më të freskët dhe janë në fuqi derisa të jetë jeta, pasi pas tij nuk do të ketë peygamber tjetër.

### 3. Fjala e Tevhidit

Muslimani lirisht duhet ta manifestojë përkatësinë e vet fetare, duke mos u frikësuar nga askush.

Feja Islame shprehet në dy mënyra: a) me fjalën e Tevhidit, dhe b) me fjalën e Shehadetit.

Fjala e Tevhidit është ajo që dëshmon veçanësinë e Zotit.

Fjala e Tevhidit apo e veçanësisë është kjo shprehje:

“Nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut, Muhammedi është Peygamberi i Allahut”.

Kjo shprehje quhet “Fjala e veçanësisë”, sepse me këtë e vërtetojmë se shpirti ynë beson se “Zoti është Një”.

Këtë shprehje mund ta shqiptojmë edhe në gjuhë të tjera. P.sh. në gjuhën arabe ajo është kështu:

“La ilahe il-l’All-llah, Muhammedun Resulull-llah”.

Kjo shprehje arabe quhet “Fjala e Tevhidit”.

Atë duhet ta mësojnë përmendsh të gjithë muslimanët dhe ta deklarojnë sa herë që u kujtohet Zoti.

#### 4. Fjala e shehadetit

Fjala e Shehadetit përbëhet nga këto fjalë: “Dëshmoj se përveç All-llahut nuk ka hyjni tjetër dhe dëshmoj se Muhammedi a.s. është rob dhe i dërguar i Zotit ”.

Kjo shprehje quhet “Fjala e dëshmisë”, sepse me atë muslimani e dëshmon veçanësinë e All-llahut xh.sh. dhe peygamberinë e hazreti Muhammedit a.s.

Kjo shprehje arabisht thuhet kështu: “Eshhedu en la ilahe il-l’All-llah ve eshedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”.

Ajo njihet si “Fjala e Shehadetit”.

Edhe këtë shprehje të gjithë muslimanët duhet ta mësojnë përmendsh



dhe ta thonë shpesh, sepse është një shprehje që e qetëson dhe e kënaq ndërgjegjen.

## Përkufizim

Të gjithë ata që falen në xhami besojnë njëlloj dhe janë muslimanë.

Pika e parë që i bashkon muslimanët është: “Besimi në një Zot të Vërtetë e të Amshueshëm”.

Pika e dytë ku muslimanët bashkohen është: “Besimi në Pejgamberin”.

Pejgamberi i muslimanëve është hazreti Muhammedi alejhisselam.

Çdo musliman e deklaron fenë e vet duke e shprehur fjalën e Tevhidit dhe Shehadetit.

Fjala e Tevhidit është kjo:

“La ilahe il-l’allah, Muhammedun Resulull-llah”.

Fjala e Shehadetit është kjo:

“Eshhedu en la ilahe il-l’Allah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”.

Pyetje:

Në cilat pika Bashkohen ata që shkojnë në xhami?

Si e besojnë muslimanët Zotin?

Cilët janë zotërat e rrejshëm?

Kush ua ka dëftuar muslimanëve Zotin e vërtetë?

Kë e quajmë Pejgamber ose i Dërguar?

Sa është numri i pejgamberëve?

Cili është pejgamberi i parë e cili i fundit?

Cilin pejgamber e pasojmë ne muslimanët?

Pse urdhrat e hazreti Muhammedit a.s. do të jenë gjithnjë në fuqi?

Me cilat fjalë e dëfton fenë e vet muslimani?

Cila është fjala e Tevhidit dhe si thuhet arabisht?

Cila është fjala e Shehadetit dhe si thuhet arabisht?



# 7 Kush na e ka mësuar fenë?

Ata që e besojnë All-llahun dhe Pejgamberët e Tij quhen muslimanë, ndërsa feja e tyre është Feja Islame.

Ajo është fe të cilën e pranojnë mendja dhe ndërgjegjja. Pikërisht për këtë shkak Islami është fe e përshtatshme për çdo njeri të mençur e të ndërgjegjshëm. Kjo fe e lartë kërkon arsye, dituri dhe virtyte.

Atë na e ka mësuar njeriu madhështor, hazreti Muhammedi a.s., të cilin duhet ta përkujtojmë me shumë nderime. Kur të përmendet emri i tij, duhet të thuhet: “Hazreti Muhammedi Alejhisselam”.

Hazreti Muhammedi Alejhisselam nuk e shpiku Fenë Islame, por atë e solli prej Zotit të Madhëruar. Ky zotëri i lartë u rrit i varfër e jetim. Ai nuk ka mësuar në shkollë si ne. Atë e mësoi vetë All-llahu

xh.sh. me anë të engjëllit. Këtë gjë e vërteton Kur'ani, libri i shenjtë i Fesë Islame. Kur'ani është libër shumë i bukur në të cilin janë dhënë urdhrat e larta e të shenjta të All-llahut xh.sh.

Një libër të tillë të shenjtë (e të ngjashëm) si Kur'ani, deri më sot nuk ka arritur ta shkruajë asnjë dijetar në botë. Të gjithë ata që e studiojnë këtë libër të shenjtë, habiten me urtësinë, lartësinë dhe bukurinë e tij.

Siç shihet, këtë libër kaq të bukur na e ka mësuar hazreti Muhammedi a.s. Pasi ai ishte njeri i pashkolluar, Kur'ani është një mrekulli (mu'xhize) që dëshmon se hazreti Muhammedi a.s. diturinë e ka marrë prej Zotit. Prandaj, urdhrat e hazreti Muhammedit a.s. duhet t'i dëgjojë çdo njeri në botë, sepse, siç thotë vetë All-llahu xh.sh. në Kur'an, atë e ka dërguar që t'ia mësojë të vërtetën mbarë njerëzisë.



## Përkufizim

Ata që e besojnë All-llahun e Madhërueshëm dhe Pejgamberët e Tij quhen muslimanë, ndërsa feja e tyre është Feja Islame.

Fenë Islame na e ka mësuar një njeri shumë i urtë, hazreti Muhammedi, a.s., të cilin duhet ta kujtojmë me nderime të shumta.

Kur'ani është libër i shenjtë i Fesë Islame, në të cilin janë dhënë urdhrat dhe porositë e Zotit.

Kur'anin na e ka mësuar hazreti Muhammedi a.s., e atij ia mësoi All-llahu xh.sh. me anë të engjëllit.

Pyetje:

Kush quhet musliman?

Si quhet feja e muslimanëve?

Çka është Feja Islame dhe çka kërkon ajo?

Kush na e ka mësuar këtë fe?

Si duhet të përkujtohet emri i Pejgamberit tonë?

Si vërtetohet se hazreti Muhammedi a.s. Fenë Islame e solli prej All-llahut xh.sh.?

Ç'është Kur'ani?

# 8 Hazreti Muhammedi dhe jeta e Tij

Hazreti Muhammedi a.s. u lind në Siujdhesën e Arabisë, në qytetin e Mekkes para 14 shekujve. Babai i tij quhej Abdullah, i cili ishte i biri i Abdu'l-Muttalibit, kurse e ëma Amine Vehebi. Ai ka qenë nga familja Hashim e fisit Kurejsh. Kur u lind Muhammedi, i ati i kishte vdekur, ndërsa edhe e ëma e la të vogël - gjashtë vjeç. Ky jetim fisnik u rrit nën përkujdesjen e gjyshit të tij, Abdu'l Muttalibit, e me vdekjen e tij këtë detyrë e mori xhaxhai i tij, Ebu Talibi.

Hazreti Muhammedi a.s. kishte moral shumë të lartë, ka qenë i butë, zemërbardhë e fisnik. Kishte një fytyrë shumë të bukur, ishte i buzëqeshur, gojëmbël e orator i shkathët. Ishte i mëshirshëm, i dhembshëm, zemërmirë, trim, i zgjuar, i kuptueshëm e i urtë. Thënë shkurt, ai ka qenë njeriu më i mençur dhe më i përkryer në botë.

bb



Hazreti Muhammedi a.s. me këto virtyte të larta e fitoi simpatinë dhe dashurinë e të gjithë banorëve të Mekkes, të cilët e donin dhe e nderonin pa masë e pa përjashtim.

Kur u bë 40-vjeçar, i erdhi engjëlli i dërguar prej All-llahut dhe i tha: “Ty, o Muhammed, të ka zgjedhur All-llahu mbi të gjithë njerëzit dhe të ka ngarkuar që t’ia tregosh njerëzisë rrugën e urtë e të drejtë, sipas urdhrave dhe porosive që do t’i japë vetë All-llahu i Madhëruar”.

Kur filloi t’ia kumtojë popullit këto urdhra të All-llahut, disa e besuan, e disa jo vetëm që nuk e besuan, por edhe filluan ta urrejnë, t’i bëhen armiq dhe ta luftojnë.

Në atë kohë populli i Mekkes i besonte për zot disa statuja prej guri, të cilat i kishin gdhendur me dorë të vet. Ata që besojnë në idhuj, quhen idhujtarë. Banorët e Mekkes pra, ishin idhujtarë. Hazreti Muhammedi a.s. u bëri thirrje këtyre të heqin dorë nga rruga e



gabueshme e idhujtarisë dhe ta besonin Zotin e Vërtetë e të Amshueshëm.

Kjo thirrje e hazreti Muhammedit a.s. i hidhëroi idhujtarët e Mekkes, të cilët filluan ta mendojnë shumë keq, me qëllim që ta detyrojnë të heqë dorë nga feja e re. Por, edhe krahas këtyre mundimeve, hazreti Muhammedi a.s. nuk hoqi dorë nga puna e tij. Më në fund idhujtarët vendosën ta vrasin. Atëherë hazreti Muhammedi a.s. u largua në një qytet tjetër, në Medine, që është 12 ditë (rrugë të ecur në këmbë) larg Mekkes. Populli i Medines e priti jashtëzakonisht mirë hazreti Muhammedin a.s. dhe shokët e tij.

Hazreti Muhammedi në Medine e përhapri shumë shpejt Fenë Islame, kështu që për pak kohë mësimet e shenjta të këtij burri të madh u përhapën në mbarë Arabinë. Kur u bë hazreti Muhammedi a.s. 63-vjeçar, në Arabi nuk kishte mbetur asnjë idhujtar, por të gjithë e pranuan Fenë Islame. Në



këtë kohë, kur ishin plotësuar të gjitha urdhrat e Zotit, hazreti Muhammedi a.s. ndërroi jetë.

## Përkufizim

Hazreti Muhammedi alejhisselam u lind në Arabi, në qytetin e Mekkes para 14 shekujve. Babai i tij quhej Abdullah, kurse e ëma Amine.

Muhammedi a.s. ka qenë njeri shumë i urtë, i sjellshëm e i mençur. Kur u bë 40-vjeçar, i erdhi engjëlli i dërguar prej All-llahut dhe i tha:

“Ty, o Muhammed, të ka zgjedhur All-llahu mbi të gjithë njerëzit dhe të ka ngarkuar t’ua tregosh rrugën e drejtë”.

Banorët e Arabisë në fillim refuzuan që t’i pranojnë urdhrat e Zotit, por më vonë i dëgjuan të gjitha dhe u bënë muslimanë.

Hazreti Muhammedi ndërroi jetë në qytetin e Medines në Arabi, në moshën 63-vjeçare.

Pyetje:  
Ku u lind hazreti Muhammedi?  
Kush ishte ai?  
Çfarë morali kishte?  
Çka i ndodhi hazreti Muhammedit kur  
u bë 40-vjeçar?  
Çka besonin banorët e Mekkes?  
Pse mekkasit u hidhëruan me hazreti  
Muhammedin?  
Ku u strehua hazreti Muhammedi dhe  
pse?  
Kur ndërroi jetë hazreti Muhammedi?





# 9 Abdesti

Abdest quhet pastrimi të cilin e bëjnë muslimanët kur dëshirojnë t'i luten All-llahut xh.sh.

Si merret abdesti?

Për të marrë abdest, duhet të veprojmë kështu: t'i lajmë duart, ta lajmë gojën, ta lajmë hundën, ta lajmë fytyrën, t'i lajmë krahët deri në bërryla, ta fërkojmë kokën me dorë të lagur, ta lëmojmë qafën me duar të lagura dhe t'i lajmë këmbët deri në nyje.



1 lajmë duart

71



Me dorën e  
djathtë e lajmë  
gojën dhe hundën  
nga tri herë.







E lajmë fytyrën  
dhe krahët deri  
në Bërryla.





E fërkojmë  
kokën me dorë të  
lagur dhe  
i lajmë veshët.







E lëmojmë qafën  
me duar të lagura  
dhe i lajmë këmbët  
deri në nyje.



Nga këto veprime, katër janë të domosdoshme: larja e fytyrës, e duarve, larja e një të katërtës së kokës dhe larja e këmbëve, që medoemos duhet të kryhen, pasi janë detyra të domosdoshme pa të cilat nuk mund të vlejë abdesti. Këto katër veprime quhen “farzet e abdestit”.

Veprimet e tjera quhen “sUNETET e abdestit” dhe janë punë të mira, të cilat i ka kryer hazreti Muhammedi a.s. për ta plotësuar sa më mirë abdestin. Prandaj edhe ne duhet t’i kryejmë.

Ndër veprat e mira të hazreti Pejgamberit a.s. është edhe pastrimi i dhëmbëve me misvak.

Abdestin e prishin këto punë:

1. Kryerja e nevojës së madhe apo të vogël, 2. Rrjedhja e gjakut apo diç tjetër nga ndojë pjesë e trupit, 3. Të vjellurit me gojë plot, 4. Të alivanosurit ose të dehurit, 5. Të qeshurit me zë në namaz.

Të mirat dhe dobitë nga abdesti:

Abdesti e freskon trupin, i jep gjallëri lëvizjes së gjakut dhe i pastron gjymtyrët



që janë në kontakt me botën dhe që përlyhen gjatë punës.

Abdesti na ruan nga sëmundjet dhe na e përmirëson shëndetin.

Abdesti na e ndriçon fytyrën, na e largon mërzinë, na bën fytyrëqeshur dhe në këtë mënyrë, e fitojmë dashurinë e njerëzve.

Abdesti, ashtu siç na e pastron trupin, na e pastron edhe mendjen e shpirtin dhe kështu na përgatit që t'i falemi e t'i afrohemi Zotit të Madhëruar.

Me një abdest mund të falemi disa herë, por meqë nga ai i kemi të gjitha këto të mira, pra ai na i siguron këto dobi, është më mirë për ne që ta përtërijmë abdestin sa herë që të falemi.

Muslimani i mirë nuk rri kurrë pa abdest.

## Përkufizim

Abdest quhet pastrimi që e bëjnë muslimanët kur dëshirojnë t'i luten All-llahut xh.sh.

Për të marrë abdest duhet t'i bëjmë këto veprime: t'i lajmë duart, ta lajmë gojën, ta lajmë hundën, ta lajmë fytyrën, t'i lajmë krahët deri në bërryla, ta lëmojmë kokën me dorë të lagur, t'i lëmojmë veshët me gishtërinj të lagur, ta lëmojmë qafën me duar të lagura dhe t'i lajmë këmbët deri në nyje.

Pyetje:

Çka quajmë abdest?

Si merret abdesti?

Cilat janë farzet e abdestit?

Cilat janë sunetet e abdestit?

Çka quajmë farz?

Çka quajmë sunet?

Si prishet abdesti?

Cilat janë të mirat dhe dobitë e abdestit?

Kur duhet të merret abdesti?



# 10 Të falurit – namazi (lavdërimi i Zotit)

Meqë All-llahu xh.sh. na i ka dhuruar të gjitha të mirat, edhe ne duhet ta duam shumë, ta nderojmë pa masë dhe t'i jemi mirënjohës për të mirat e panumërta që na i ka dhënë. Kjo mirënjohje kryhet duke e madhëruar vetëm All-llahun e Madh e askënd tjetër.

All-llahun mund ta madhërojmë duke u falur sipas mënyrës që na e ka mësuar hazreti Muhammedi a.s.

Mënyra të cilën na e ka mësuar hazreti Muhammedi a.s. për t'iu falur Zotit është kjo që shihet në ilustrimet në faqet vijuese.

Për t'u falur sipas kësaj mënyre, duhet t'i bëjmë këto veprime:

Të bëhet nijjeti –  
vendosja, të  
ngrihen duart deri  
në veshë te  
burrat, e deri në  
krahëror te gratë  
dhe të thuhet  
"All-llahu Ekber".







Të lidhen duart  
dhe të këndohet  
pak Kur'an.



Duke thënë  
"All-llahu Ekber"  
përkulemi  
përpara. Kjo  
përkulje quhet  
"Ruku". Në Ruku  
tri herë thuhet  
"Subhane  
rabbijel adhim".



Ngrihemi në  
këmbë duke thënë  
"Semiallahulimen  
hamideh".







E vëmë Ballin në tokë duke thënë "All-llahu Ekber". Ky veprim quhet "Sexhde". Në sexhde tri herë thuhet "Subhane rabbijel a'la".



Ngrihemi prej sexhdes duke thënë "All-llahu Ekber". Përsëri e kryejmë sexhden duke thënë si më parë.

Lidhen duart  
dhe këndohet  
pak Kur'an..



Duke thënë  
"All-llahu Ekber"  
përkulemi përpara.  
Kjo përkulje  
quhet "Ruku".  
Në Ruku tri  
herë thuhet  
"Subhane  
rabbijel adhim".



Ngrihemi në këmbë  
duke thënë  
"Semiallahulimen  
hamideh".







E vëmë Ballin në tokë duke thënë "All-llahu Ekber". Ky veprim quhet "Sexhde".



Në sexhde tri herë thuhet "Subhane rabbijel a'la".



Ngrihemi prej sexhdes duke thënë "All-llahu Ekber". Përsëri e kryejmë sexhden duke thënë si më parë.

Qëndrojmë  
në gjuhë dhe e  
madhërojmë  
Zotin me ndojë  
lutje. Në fund e  
këndojmë fjalën  
e Shehadetin.








Në mBarim të të  
falurit e kthejmë  
kokën në të dyja  
anët (duke filluar  
nga e djathta), e  
duke thënë:  
"Esselamu alejkum  
ve rahmetull-llah".





Pas namazit  
Bëhet lutja.



## Kushtet e namazit

Para se të fillohet falja e namazit, duhet të plotësohen këto kushte:

- Të marrim abdest ose nëse ka nevojë gusëll.
- Të jenë të pastra trupi, rrobat dhe vendi ku falemi.
- Të vishemi që të mos na duken vendet e turpshme.
- Të kthehemi kah Kibleja.
- Ta dimë kohën e namazit.
- Ta bëjmë nijjet.

## Farzet e namazit

Farzet e namazit janë gjashtë:

- Të themi “All-llahu Ekber”;
- Të qëndrojmë në këmbë;
- Të lexojmë Kur’an;
- Të përkulemi (ruku);
- Të biem në sexhde dhe
- Të qëndrojmë në gjunj.

Muslimanët falen pesë herë në ditë.

Në mëngjes para se të lindë dielli - dy rekate;

Në drekë (pas zevalit) - katër rekate;  
Në ikindi - po ashtu katër rekate;  
Në mbrëmje - akshami, pas  
perëndimit të diellit - tri rekate;  
Në darkë – jaci - katër rekate.

### **Të mirat dhe dobitë e namazit**

Ai që falet i ka këto dobi e të mira:

- E ka zbatuar urdhrin e Zotit;
- Ka trup të shëndoshë e të shkathët;
- Ka mendje të kulluar;
- Ka ndërgjegje të pastër;
- Ka shpirt të qetë e të kënaqur.

Është e domosdoshme që njeriu  
namazin ta bëjë me gjithë zemër dhe  
duke e pasur mendjen vetëm tek  
All-llahu i Madhërueshëm.



## Përkufizim

All-llahun e Madhërueshëm duhet ta lavdërojmë duke iu lutur rregullisht.

Kushtet e namazit janë gjashtë:

- Të marrim abdest ose nëse ka nevojë gusëll;
- T'i kemi të pastra trupin, rrobat dhe vendin ku do të falemi;
- Të vishemi që të mos na duken vendet e turpshme;
- Të kthehemi kah Kibleja;
- Ta dimë kohën e namazit dhe
- Të bëjmë nijet.

Farzet e namazit janë:

- Të themi “All-llahu Ekber”;
- Të qëndrojmë në këmbë;
- Të lexojmë Kur'an;
- Të përkulemi (ruku);
- Të biem në sexhde dhe
- Të qëndrojmë në gjunjë.

Muslimanët duhet të falen pesë herë në ditë: në mëngjes (sabah), në drekë (dhuhr), në ikindi (asr), në mbrëmje-aksham (magrib) dhe në darkë - jaci (isha).

Pyetje:

Pse e lavdërojmë All-llahun xh.sh.?

Si e lavdërojmë Atë?

Si i lutemi Atij?

Çka quhet rekat?

Cilat kushte duhet të plotësohen para faljes?

Cilat janë farzet e namazit?

Sa herë në ditë muslimanët falen?

Cilat janë të mirat dhe dobitë nga namazi?



# || Netët e mira (të mëdha)

Festat fetare të muslimanëve nuk llogariten me kalendarin e Diellit, por me atë të Hënës.

Sipas kalendarit të Hënës (Lunar), viti ka 12 muaj; secili prej tyre fillon me Hënën e re. Emrat e muajve të Hënës janë këta:

1. Muharrem; 2. Safer; 3. Rebiu-l-evvel;  
4. Rebiu-l ahir; 5. Xhumade-l-ula;  
6. Xhumade-l-ahir; 7. Rexheb; 8.  
Sha'ban; 9. Ramadan; 10. Shevval;  
11. Dhu-l-ka'de dhe 12. Dhu-l-hixhxhe.

Në disa nga këta 12 muaj ka disa ditë e disa net të shenjta që muslimanët i kremtojnë. Ato quhen “festa fetare”. Këto festa janë:

- Dita e 10-të e Muharremit është Dita e “Ashuras”.

- 12 Rebiu-l-evveli është nata e madhe e “lindjes” së hazreti

Muhammedit alejhisselam. Kjo natë quhet “Nata e Mevludit”.

- Nata e madhe e “Regaibit” është nata e parë e premtë e muajit Rexheb.

- Nata e madhe e “Miraxhit”, e cila bie natën e 27 të muajit Rexheb.

- Nata e madhe e “Beratit” bie në natën e 15-të të muajit Sha’ban.

- I tërë muaji i Ramazanit, kur muslimanët agjërojnë, por nuk bëjnë pushim (nga puna).

- Nata e madhe e “Kadrit”, e cila bie në natën e 27-të të Ramazanit.

- “Bajrami i Ramazanit” bie tri ditët e para të muajit Shevval.

- Dita e “Arefesë” bie në ditën e nëntë të Dhu-l-hixhhes.

- “Bajrami i Haxhit” ose “Bajrami i Kurbanit” bie katër ditë rresht pas ditës së “Arefes”.

Këto festa muslimane duhet të përcillen me lutje.



## Përkufizim

Festat fetare të muslimanëve llogariten sipas muajve të Hënës.

Festat muslimane janë këto:

Dita e Ashures, Nata e Mevludit, Nata e Regaibit, Nata e Miraxhit, Nata e Beratit, tërë muaji i Ramazanit, Nata e Kadrit, Bajrami i Ramazanit, Dita e Arefes, Bajrami i Haxhit ose Bajrami i Kurbanit.

Muslimanët këto festa duhet t'i përcjellin me lutje.

Pyetje:

Si llogariten festat fetare të muslimanëve?

Cilët janë muajt e Hënës?

Cilat janë festat e muslimanëve?

# 12 Ramazani dhe agjërimi

Aliu: Tungjatjeta z. Rustem!

Rustemi: Tungjatjeta, urdhëro të hamë!

Aliu: Të hamë bukë në Ramazan? Jo zotëri, unë agjëroj.

Rustemi: Çka do të thotë agjërimi?

Aliu: Agjërimi do të thotë të heqësh dorë nga ngrënia, nga pirja dhe nga të gjitha punët që e prishin agjërimin. Agjërimi fillon që nga agimi e deri kur të perëndojë dielli.

Rustemi: Kush duhet të agjërojë?

Aliu: Duhet të agjërojë çdo musliman i mençur që e ka arritur moshën e pjekurisë, që ka fuqi për të agjëruar dhe që nuk ka kurrfarë pengesash.

Rustemi: Në cilin muaj duhet të agjërohet?

Aliu: Agjërimi kryhet në muajin e Ramazanit, posa të shihet Hëna e re.

Rustemi: Ti ende je i vogël. Unë kam parë shumë të vegjël si ne që nuk agjërojnë.



Aliu: Si urdhëron, por unë dua të stërvitem me agjërim qysh si i vogël.

## DOBITË E AGJËRIMIT

Nga agjërimi kemi dobi të shumta.

Këtu po i theksojmë vetëm disa prej tyre:

- Agjërimi e stërvit njeriun t'i bëjë ballë urisë e etjes, kështu që vështirësitë e rastit t'i përballojë më lehtë.

- E rregullon lukthin dhe siguron shëndet. Edhe mjekët për shumë sëmundje e këshillojnë agjërimin.

- E forcon vullnetin dhe e bën njeriun ta ruajë veten nga të ligat.

- Na e forcon mendjen dhe na e përmirëson shpirtin e sjelljen. "I ngopuri të uriturin s'e beson"- kanë thënë pleqtë e dijshtëm. Që ta besojmë të varfërin e uritur, duhet ta provojmë urinë e tij, gjë që bëhet duke agjëruar.

- Së fundi, e kemi zbatuar urdhrin e lartë të Zotit të Madhëruar, i Cili na do më tepër se çdokush tjetër.

Njeriu që agjëron nuk lejohet të bëjë vepra të këqija, nuk duhet të flasë fjalë të shëmtuara e gënjeshtra, por edhe nuk duhet të dëgjojë gënjeshtra e fjalë të ndyta, e as të shohë punë të liga. Gjithashtu, ai nuk duhet të shkojë nëpër vende të dyshimta e të shoqërohet me shokë të këqij.

Nga agjërimi lirohen: të sëmurët, udhëtarët, pleqtë, gratë shtatzëna dhe lehonat. Nga agjërimi lirohen edhe ata të cilët i ka kapluar uria dhe etja në një shkallë të padurueshme.

Ata që e prishin me arsye agjërimin, duhet ta zëvendësojnë në ndonjë ditë tjetër kur të kenë mundësi, e nëse nuk mund ta zëvendësojnë me agjërim, duhet ta zëvendësojnë me të holla duke i falur një të varfëri ushqim sa për një ditë.

## Përkufizim

Në muajin e bekuar të Ramazanit muslimanët duhet të agjërojnë.



Agjërimi do të thotë të mos hahet e të mos pihet fare, që nga mëngjesi e deri në mbrëmje.

Muslimanët e muslimanet që e kanë arritur moshën e pjekurisë e që nuk kanë ndonjë sëmundje ose pengesë tjetër, duhet të agjërojnë.

Agjërimi është shumë i dobishëm.

Pyetje:

Çka nënkupton agjërimi?

Kush duhet të agjërojë?

Në cilin muaj agjërohet?

Cilat janë dobitë e agjërimit?

Kush lirohet nga agjërimi?

Çka duhet të bëjnë ata që me arsye e prishin agjërimin?

# 13 Ndihma të varfërve

## I. Zekati

Sipas Fesë Islame, All-llahu xh.sh. nuk madhërohet vetëm duke iu lutur, por madhërohet edhe duke ua siguruar jetën të varfërve.

Muslimanët e vërtetë, para se t'i plotësojnë nevojat e tyre për ushqim, duhet të pyesin se a mos ka mbetur pa bukë ndojë njeri, qoftë i njohur apo i panjohur. Muslimanët që sillen në këtë mënyrë, e kanë madhëruar Zotin më tepër se pasanikët që luten shumë, por nuk u digjet zemra për të varfërit.

“Nuk do të jeni të lumtur kurrë (nuk do ta arrini lumturinë) po qe se nuk ua ndani të varfërve atë që e dëshironi për vete” - urdhëron All-llahu xh.sh. në Kur'an.

Zoti muslimanëve të pasur u ka caktuar ta paguajnë një tatim vjetor, i cili njihet me emrin “Zekat”.

Zekati u ndahet këtyre personave:



- Të varfërve që nuk mund ta sigurojnë ushqimin.
  - Të varfërve që nuk kanë kurrfarë kushtesh për jetë.
  - Udhëtarit që ka mbetur rrugëve pa mjete e nuk ka me çka të jetojë.
  - Strehimoreve për të varfër.
  - Spitaleve që i shërojnë të varfërit.
  - Strehimoreve, konvikteve dhe shkollave që merren me edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të varfër.
  - Medreseve e studentëve të varfër që studiojnë mësimet e Kur'anit, me qëllim që t'ia predikojnë njerëzimit.
  - Bashkësisë Islame, e cila përpiqet për lartësimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e Fesë Islame te ne.
  - Veprimtarisë botuese islame, që përpiqet për përhapjen e moralit islam.
  - Vendeve të tjera ku paraqitet ndonjë nevojë aktuale, për të cilën merr vendim Kryesia Supreme e Bashkësisë Islame.
- Zekati paguhet 2,5 për qind, do të thotë ata që kanë, bie fjala, 100 denarë,

do të paguajnë dy denarë e gjysmë në emër të zekatit.

## 2. Sadakaja

Zekati është detyrim vetëm për të pasurit. Ky paguhet një herë në vit. Mirëpo, pasaniku bujar e fisnik, kurdoherë mund t'u dhurojë të varfërve nga ndonjë send. Kjo dhënie quhet "sadaka" ose "kontribut i singertë i të pasurve".

Muslimanët për Bajram të Ramazanit e kanë për detyrë të paguajnë një sadaka të zakonshme e të caktuar. Kjo sadaka quhet "fitër", sasia e së cilës është aq sa t'ia sigurojë një të varfëri të rritur ushqimin e një dite.

## 3. DOBIA nga zekati dhe sadakaja

Zekati e sadakaja garantojnë jetën e të varfërve e kështu e sigurojnë qetësinë e vendit, i vëllazërojnë pasanikët me të varfërit dhe kështu nuk mbetet vend për urrejtje, armiqësi dhe anarki. Zekati e



sadakaja janë edhe lutje e adhurime që na afrojnë te Zoti i Madhëruar.

## Përkufizim

Zoti nuk madhërohet vetëm me lutje (namaz), por edhe me dhënie (zekat e sadaka).

Muslimanët e pasur, para se t'i plotësojnë nevojat e veta për ushqim, duhet të pyesin se a mos ka mbetur pa bukë ndonjë i varfër.

Ndihma që pasanikët ua japin të varfërve quhet zekat ose sadaka.

Zekati duhet të jepet domosdo, kurse sadakaja jepet me dëshirë.

All-llahu i Madhëruar i do muslimanët të cilët e paguajnë zekatin ose që japin sadaka.

Pyetje:

Pos me lutje, si madhërohet ndryshe  
Zoti?

Çka duhet të bëjnë muslimanët para  
se t'i plotësojnë nevojat e veta për ushqim?

Çka urdhëron Zoti në Kur'an?

Ç'është zekati?

Ç'është sadakaja?

Kur quhet sadakaja fitër?

Ç'dobi sjellin zekati e sadakaja?





# 14 Bajrami i kurbanit

Bajrami i Kurbanit është festë fetare e muslimanëve, të cilin ne e quajmë edhe “Bajrami i Vogël”, mirëpo këtij termi duhet t’i shmangemi. Ky bajram zgjat katër ditë. Bie në muajin e Dhu-l-hixhhes duke filluar nga dita e dhjetë e tij.

Zoti i Madhëruar ka urdhëruar që në këtë bajram të pasurit të therin nga një kurban. Prandaj ky bajram quhet “Bajrami i Kurbanit”.

“Kurban” do të thotë “sakrificë ose flijim”.

Muslimani me kurbanin e tij e shpreh besimin e tij ndaj Zotit dhe gatishmërinë për t’i flijuar të gjitha interesat e veta për zbatimin e Urdhrit Hyjnor e në dobi të njerëzimit.

Pasaniku i cili në tryezën e tij të begatshme gostitet dita më ditë me mish të llojllojshëm, si të qengjit, zogut, pulës e peshkut, duhet të sjellë ndër mend se



afër tij ka edhe njerëz të varfër të cilët mishin nuk e shohin kurrë me sy.

Këta pasanikë Zoti i ka urdhëruar që në Bajram të Kurbanit të therin nga një kurban, e mishin e tij ta ndajnë në tri pjesë: një pjesë t'ua shpërndajnë të varfërve, një pjesë farefisit dhe një pjesë ta mbajnë për ushqimin e fëmijëve të vet.

Nuk mund të lirohemi/shkarkohemi nga detyra e kurbanit, po që se ua shpërndajmë të varfërve vlerën e kurbanit në para. Prandaj, kurbanit nuk mund të zëvendësohet e të anulohet në asnjë mënyrë.

Kurban mund të bëhen: deshtë, delet, dhitë, cjeptë, lopët, qetë, buajt e devetë. Njëra prej këtyre katër kafshëve të fundit, si kurban vlen për shtatë persona. Ato kafshë nuk lejohet të jenë të verbra, të çala, të sëmura, me të meta e të ligshhta.

Qengjat dhe edhat që s'e kanë mbushur motin, pastaj lopët e buajt që s'i kanë mbushur dy vjet dhe devetë që s'i kanë mbushur pesë vjet, nuk vlejnë për kurban.



## Përkufizim

Bajrami i Kurbanit është festë e shenjtë, në të cilën muslimanët e pasur therin nga një kurban, mishin e të cilëve ua shpërndajnë të varfërve që nuk kanë para për të blerë mish.

Bajrami i Kurbanit është festë e cila i gëzon të pasurit e të varfërit.

Pyetje:

Ç'është Bajrami i Kurbanit?

Ç'bëjnë muslimanët e pasur në këtë Bajram?

Ç'do të thotë kurban?

Çfarë Besimi i shpreh Zotit të Madhëruar muslimani i cili ther kurban?

Cila është dobia e kurbanit?

A mund të shkarkohemi nga kurbanit me para?

Si ndahen pjesët e kurbanit?

Cilat shtazë theren kurban?

# 15 Haxhilerët

Ne, muslimanët, kur i lutemi Zotit të Madhëruar, fytyrën e trupin e kthejmë kah Kibla. Ajo gjendet në juglindje të horizontit. Edhe xhamia ndërtohet me pjesën e përparme kah Kibla.

Fjala “Kible” e ka kuptimin e fjalës “drejtim”.

E dini se Pejgamberi ynë, hazreti Muhammedi alejhisselam, është lindur në qytetin e Mekkes, në të cilin ndodhet një tempull i shenjtë që quhet “Qabe”. Pra, kur i lutemi Zotit, e kthejmë fytyrën tonë kah Qabeja. Ky veprim quhet “Kible”.

All-llahu i Madhëruar muslimanëve që kanë mundësi materiale, ua ka vënë për detyrë që një herë në jetë të bëjnë një udhëtim deri në Mekke, me qëllim që ta vizitojnë tempullin e shenjtë të Qabes. Muslimanët që e kryejnë këtë udhëtim quhen haxhilerë.

Haxhillëku bëhet gjatë ditëve të



Bajramit të Kurbanit, prandaj ky bajram ndryshe mund të quhet edhe “Bajrami i Haxhilerëve”.

Të gjithë haxhilerët që janë të mbështjellur me një pëlhurë të bardhë e cila quhet “Ihram”, Ditën e Arefes shkojnë në malin Arafat që gjendet afër Mekkes, ku qëndrojnë një kohë dhe i luten Zotit të Madhëruar.

Tubimi i madh në Arafat është shprehje e barazisë së vërtetë të njerëzve para Zotit. Aty të gjithë muslimanët janë të barabartë pa kurrfarë dallimi, çfarëdo grade a pozite të kenë, sepse të gjithë janë të veshur njëllorj, me ihram të bardhë.

Haxhilerët, pasi të qëndrojnë Ditën e Arefes disa orë në malin e Arafatit, kthehen në Mekke, ku ia bëjnë nderimet e duhura tempullit të shenjtë të Qabes.

Haxhillëku paraqet një kuvend të madh, ku muslimanët mund të bisedojnë për problemet e mëdha të njerëzimit. Prandaj, ata nuk duhet ta lënë pas dore këtë adhurim.

## Përkufizim

Pejgamberi ynë i madh, hazreti Muhammedi alejhisselam, u lind në Mekke. Aty ndodhet tempulli i shenjtë që quhet Qabe.

Kur i lutemi Zotit, ne e kthejmë fytyrën kah Qabeja, e cila quhet edhe Kible.

Zoti i Madhëruar ka urdhëruar në Kur'an që muslimanët të cilët kanë mundësi materiale, ta vizitojnë së paku një herë në jetën e tyre Qaben. Kjo vizitë quhet haxhillëk.

Haxhillëku bëhet gjatë ditëve të Bajramit të Kurbanit. Prandaj ky bajram quhet edhe "Bajrami i Haxhilerëve".

Pyetje:

Në ç'drejtim kthehen muslimanët kur luten?

Në ç'anë është Kibla?

Çka do të thotë Kible?

Ç'është Qabeja?

Kush quhet haxhi?

Ç'është haxhillëku?

Kur kryhet haxhillëku?

Si kryhet haxhillëku?

Çka quhet "ihram"?

Kush quhet Arafat?

Çfarë dobie sjell haxhillëku?



# 16 Morali i hazreti Muhammedit A.S.

Njerëzit në këtë botë janë të mirë ose të këqij. Të mirë janë ata të cilët para se t'i rregullojnë punët e veta, mendojnë t'i rregullojnë punët e të tjerëve. Njerëzit e tillë e kanë zemrën e butë dhe ndiejnë keqardhje për të tjerët.

Kur'ani na mëson se njeriu është krijuar që ta adhurojë Zotin e Madhëruar e t'i bëjë mirë njerëzisë. Për ta kryer këtë qëllim, njeriu duhet të ketë shëndet të plotë e të merret me ndojë mjeshtëri, që të mund t'u ndihmojë njerëzve të tjerë të varfër, pleq e të paaftë.

Muslimanit të shëndoshë i është e ndaluar të jetojë në kurriz të tjetërkujt. Lypsaria në Fenë Islame është gjë e ndaluar.

Gjithashtu janë të ndaluara vjedhja, grabitja dhe rrëmbimi i pasurisë së tjetrit. Muslimanit nuk i lejohet t'i bëjë dëm tjetrit.



Në Islam janë të ndaluara edhe bixhozi e kamata (fajdeja), me të cilat njeriu e përvetëson pa të drejtë pasurinë e tjetërkujt.

Ata njerëz të cilët i dëmtojnë të tjerët, duke ua marrë me dhunë ose me tradhti pasurinë, janë njerëz të këqij e të ligj.

Zoti xh.sh., për të na mësuar rrugën e drejtë, na ka dërguar mësuesin e madh të mirësisë, hazreti Muhammedin alejhisselam, i cili na i ka transmetuar të gjitha ligjet dhe urdhrat e Zotit. Këto urdhra të shenjta të Zotit, përfshihen në librin e madh e të shenjtë që quhet Kur'an.

Kur'ani i shenjtë është një libër i madh që ua mëson njerëzve sjelljet e mira dhe ligjet e urta e të mbara.

Hazreti Muhammedi alejhisselam, i cili na e ka mësuar Kur'anin, ka qenë njeriu më i mirë, më i urtë e më i sjellshëm në botë. Prandaj, njerëzit të cilët ia dëshirojnë të mirën botës, duhet të veprojnë sipas urdhrave e këshillave të hazreti Muhammedit a.s.



Hazreti Muhammedi a.s. ka qenë punëtor e jo përtac, e ka siguruar jetën e vet e të familjes me punë e me tregti.

Po ashtu ai ka qenë i pastër, si në trup ashtu edhe në sjellje.

Hazreti Muhammedi ka qenë i rregullt dhe ka vepruar sipas programit të tij.

Ai gjithnjë ka folur drejt dhe kurrë nuk ka gënjyer. Kënaqej me pak e nuk lakmonte shumë. Ai ka qenë njeri besnik dhe nuk ka tradhtuar kurrë.

Këtë njeri të lartë e të shenjtë duhet ta marrim si shembull, nëse dëshirojmë t'i përmirësojmë sjelljet e t'i rregullojmë punët tona në mënyrë të suksesshme.

## Përkufizim

Hazreti Muhammedi alejhisselam ka qenë njeri shumë i urtë e tejet i sjellshëm.

Ai kurrë nuk ka bërë punë të liga. Ishte punëtor, e nuk ishte përtac. Ai e siguronte jetën e vet e të familjes duke punuar e fituar në mënyrë të ndershme.

Hazreti Muhammedi alejhisselam ka

qenë i pastër si në trup, ashtu edhe në sjellje. Ai në çdo rast ka folur drejt e kurrë nuk ka gënjyer. Kënaqej me pak dhe nuk lakmonte pasuri. Ka qenë besnik dhe kurrë nuk ka tradhtuar.

Edhe ne duhet të përpiqemi që të bëhemi të sjellshëm e të mirë si ky zotëri i lartë.

Pyetje:

Sa llojesh janë njerëzit?

Cilët janë të mirë?

Pse u krijua njeriu?

Si mund t'ia arrijë njeriu qëllimit të vet?

Çfarë njerëz janë ata që i dëmtojnë të tjerët?

Cilat punë janë të ndaluara për muslimanin?

Pse Zoti i Madhëruar e dërgoi hazreti Muhammedin a.s.?

Ç'është Kur'ani?

Çfarë njeriu ka qenë hazreti Muhammedi a.s.?

Çfarë sjelljeje kishte hazreti Muhammedi a.s.?



# 17 Ndihma ndaj të afërmve

Muslimani duhet të jetë njeri shumë i mirë. Ai duhet të përpiqet që t'ua sigurojë jetën dhe arsimimin fëmijëve, familjes, prindërve, vëllezërve dhe motrave të veta.

Njeriu nuk mund të jetojë i vetmuar në këtë botë, por ka nevojë për shoqëri. Jeta jonë është e lumtur dhe e gëzuar, në qoftë se i kemi të lumtur e të gëzuar edhe të afërmit dhe farefisin tonë.

Të afërm nuk janë vetëm të afërmit e farefisi, por edhe fqinjët, pa marrë parasysh fenë e besimin e tyre.

Në çdo fatkeqësi që mund të na ndodhë, kush mund të na vijë në ndihmë më shpejt se fqinjët?

Me të afërmit tanë që nuk besojnë si ne, nuk duhet të bisedojmë për gjëra të fesë, as nuk duhet t'ua përbuzim apo t'ua qortojmë fenë e tyre. Sepse, feja është punë shpirti dhe çdo person beson ashtu si i dëshiron shpirti.

Në qoftë se ndonjë mik i ynë që nuk është musliman e kritikon fenë tonë, nuk duhet t'i hidhërohemi e ta urrejmë, por duhet t'i japim në dorë ndojë libër të fesë, që ta studiojë e ta kuptojë gabimin e tij.

Muslimani duhet t'u ndihmojë të gjithë miqve, duke filluar nga më i afërmi. Po të vepronin të gjithë njerëzit në këtë mënyrë, askush në botë nuk do të mbetej në mjerim.

## Përkufizim

Muslimani duhet të jetë njeri shumë i mirë. Ai duhet t'u bëjë mirë prindërve, vëllezërve, motrave, të afërmeve, farefisit dhe gjithë miqve të tjerë.

Ai duhet t'u ndihmojë të gjithë shokëve, duke filluar nga më të afërmit. Po të punonin kështu të gjithë njerëzit, askush në botë nuk do të mbetej në mjerim.



Pyetje:  
Pse duhet të përpiqet muslimani?  
A mund të jetojë njeriu i vetmuar  
në këtë botë?  
Kush janë të afërmit?  
Si duhet të sillemi me të afërmit që  
nuk i takojnë besimit tonë?



# 18 Ndihma

## Bashkatdhetarëve dhe mBarë njerëzimit

Perëndia të gjithë njerëzit i krijoi prej prindërve të njëjtë, prej hazreti Ademit e hazreti Havës. Ademi është njeriu i parë që e krijoi Zoti, prej të cilit sipas një rregulli të caktuar që e di Ai vetë, e krijoi edhe Havën, gruan e parë në botë. Këta dy vetë e formuan familjen e parë, nga e cila buron mbarë njerëzimi.

Nga kjo që u cek më sipër, merret vesh se të gjithë njerëzit janë vëllezër e motra, sepse në fillim kishin vetëm një nënë e një baba.

Atëherë, pra njeriu duhet të ushqejë dashuri për të gjithë vëllezërit e tij. Ai këtë dashuri duhet ta dëshmojë me punë e jo me fjalë. Duhet pasur dhembje për të tjerët, duhet bërë përpjekje për t'ju



ndihmuar e bërë mirë me sa fuqi që kemi dhe asnjëherë mos të bëjmë përpjekje për të bërë keq dhe dëm.

Këto sjellje të mira e njerëzore duhet të shprehen më tepër ndaj bashkatdhetarëve me të cilët bashkëjetojmë.

Na është ndaluar që t'u ndërhyjmë të tjerëve në fenë e tyre; le të besojë kush si të dojë.

Të gjithë bashkatdhetarët tanë janë vëllezër tanë, sepse ata janë gati të luftojnë krah për krah me ne, për ta mbrojtur atdheun nga rreziqet që i kërcënohen. Prandaj duhet t'i duam si vëllezër.

Për të qenë muslimanë të vërtetë, nuk mjafton vetëm t'u bëjmë mirë të afërmve, farefisit e bashkatdhetarëve tanë, por duhet t'i duam të gjithë njerëzit e botës, çfarëdo race e kombi qofshin. Sepse, edhe ata i kemi vëllezër, pasi që edhe ata janë njerëz si ne, të krijuar në fillim prej një babe e një nëne.

Të gjithë njerëzit e botës janë si një trup. Kur një gjymtyrë e këtij trupi

lëngon, dhembjen e tij duhet ta ndiejë i tërë trupi njerëzor.

## Përkufizim

Muslimani duhet të sillet mirë me të gjithë bashkatdhetarët. Neve na është ndaluar të ndërhyjmë në fenë e tjetërkujt. Bashkatdhetarët tanë, të çfarëdo feje qofshin, janë vëllezërit tanë, sepse u nënshtrohen ligjeve të njëjta dhe i gëzojnë të drejtat e njëjta si ne. Prandaj, duhet t'i duam si vëllezër dhe të bashkëjetojmë mirë me të gjithë.

Pyetje:

Si i ka krijuar Zoti i Madhëruar njerëzit?

Kush janë prindërit e parë të njerëzve?

Kush janë të afërmit tanë?

Pse duhet t'i duam bashkatdhetarët?

Pse duhet t'i duam të gjithë njerëzit?



# 19 Disa pjesë të shkurtra të Kur'anit



Kaptina "Ihlas" (Kulhuvallahi)

*Eudhu bil-lahi minesh-shejtanirr-rraxhim*

*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*

Kul huv all-llahu ehad. All-llahu  
s-Samed. Lem jclid ve lem juled ve lem  
jekun lehu kufuven ehad.

Përkthimi i "Kulhuvallahut"

*"I mbështetem All-llahut që të më ruajë  
nga djalli i mallkuar!*

*Në emër të All-llahut,*

*Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Thuaj: Ai, All-llahu, është Një.

All-llahu është që çdokush ka nevojë për  
Të. Nuk ka lindur, as nuk është i lindur  
dhe askush nuk është si Ai!"



## Kaptina "El-Asër"

*Eudhu bil-lahi minesb-shejtanirr-rraxhim*

*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*

Vel asri. Innel insane lefi-husrin. Il-  
lel-ledhine amenu ve amilus-salihati ve  
tevasav bil-hakki ve tevasav bis-sabri

## Përkthimi i "El-Asrit"

*"I mbështetem All-llahut që të më ruajë  
nga djalli i mallkuar*

*Në emër të All-llahut,*

*Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Betohem në kohën! Se njeriu vërtet  
është në humbje! Pos atyre që besuan,  
kryen punë të mira dhe këshilluan të  
vërtetën dhe durimin".





## Kaptina "El-Kevther"

*Eudhu bil-labi minesb-shejtanirr-rraxhim*

*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*

Inna a'tajna-kel-kevther. Fe sal-li li  
rabbi-ke ve-nhar.

Inne shanieke huvel-ebter.

## Përkthimi i "El-Kevtherit"

*"I mbështetem All-llabut që të më ruajë  
nga djalli i mallkuar!*

*Në emër të All-llabut,*

*Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Vërtet, Ne ta kemi dhënë (ty o  
Muhammed) Kevtherin (shumë të mira).  
Prandaj falu për Zotin tënd dhe ther  
kurban! Se vërtet ata që të urrejnë, janë  
farësosur".



## Kaptina "El-Fatiha"

*Eudhu bil-lahi mine-shsbejtanirr-rraxhim*

*Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim*

El-hamdu lil-lahi rabbil-alemin. Err-rrahmanirr-rrahim.

Maliki jevmid-din. Ijjake na'budu ve ijjake nestein.

Ihdinas-siratal-mustekim. Siratal-ledhine en-amte alejhim, gaj ril magdubi alejhim ve led-dal-lin.

## Përkthimi i "Fatijas"

*"I mbështetem All-llabut që të më ruajë nga djalli i mallkuar.*

*Në emër të All-llabut,*

*Të gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Falënderimi i takon vetëm Zotit, krijuesit të botëve.

Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit. Sunduesit të Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Na udhëzo në rrugë të drejtë. Në rrugën e atyre të cilëve ua ke dhuruar bekimin tënd, e jo në rrugën e atyre ndaj të cilëve je i zemëruar dhe të cilët kanë humbur!"

*"Amin"*





## Një salavat

All-llahumme sal-li ala sejjidina  
Muhammedin ve ala ali sejjidina  
Muhammed!

## Përkthimi i salavatit

“O Zot i Madhëruar, bekoje zotëriun  
tonë, hazreti Muhammedin alejhisselam  
dhe pasardhësit e tij”.





126



Boton: LOGOS-A



Për botuesin: Adnan Ismaili

Recensues: Muhidin Ahmeti

Redaktor letrar: Xhevat Lloshi

Redaktor artistik & Disenji: Edi Agagjyshi

Redaktor teknik & Faqosës: Naser Fera

Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup

Shtypi: Focus - Prishtinë

Kopertinë e punoi: Edi Agagjyshi



[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)







EDUKATA FETARE E MORALE

Logos-A

ISBN 998958056-1



9 789989 580567